

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË



ZYRA PËRMBARIMORE

SUELA NDRËCA

2197
26.0324

Nr. 433/5 Prot

Tiranë, më 23.02.2024

Nr. 433 Dosje

URDHËR PËR VËNIEN E SEKUESTROS KONSERVATIVE

Drejtuar : QENDRËS KOMBËTARE TË BIZNESIT ✓

Për dijëni: Debitorit: Shoqëria "Victoria Invest" shpk – Nipt K32712206U
Administrator Z. Fatmir Kuçi
Adresa: Lagjia 28 Nëntori, Rruga 11 Nëntori, Pallati pranë Tatim Taksave,
Kati 2, Elbasan

Kreditorit: Shoqërisë "ENO TD" sh.p.k.
Administrator Z. Tonin Dedaj
Adresa: Lagjia nr.14, Autostrada Durrës Tiranë, pranë karburant Kastrati, Durrës

Unë, Suela Ndreca, Përmbarues Gjyqësor, në referim të titullit ekzekutiv Fatura Tatimore të Shitjes me TVSH për të cilin është lëshuar Urdhëri i Ekzekutimit Nr. i Regjistrimit (90109-00566) 264 Datë regjistrimi 22.02.2023, Nr. Vendimi (11-2023-1032)264, Datë vendimi 03.02.2023 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, kam vënë në ekzekutim këtë Urdhër, duke regjistruar në dosjen përmbarimore Nr. 386 kërkesën e kreditorit Shoqërisë "ENO TD" sh.p.k., ndaj debitorit Shoqërisë Victoria Invest sh.p.k.

Në referim të nenit 519 të K.Pr.Civile është marrë Vendim për fillimin e ekzekutimit të detyrueshëm, duke vënë sekuestër mbi kreditë e debitorit në masën që do të jetë e nevojshme për plotësimin e detyrimit. Përsa më sipër në referim të nenit 527 e në vijim të K.Pr.Civile të neneve 31 pika (b), 32 pikat (c) dhe 46 (paragrafi i 1-rë) të Ligjit Nr. 26/2019 "Për Shërbimin Përmbarimor Gjyqësor Privat",

URDHËROJ:

1. Qendrën Kombëtare të Biznesit, të bëjë vendosjen e masës së sekuestros konservative mbi dokumentacionin e aktiveve, kuotat/aksionet e palës debitore si dhe mbi të drejtat që rrjedhin nga zotërimi i këtyre kuotave duke ndaluar tjetërsimin dhe/ose disponimin e tyre, moskryerjen e asnjë veprimi tjetër i cili mund të ndryshojë të dhënat e regjistrimit tregtar, si dhe të mospajisë me asnjë lloj dokumentacioni debitorin Shoqëria Victoria Invest sh.p.k. NIPT K32712206U, Administrator Z. Fatmir Kuçi, Adresa: Lagjia 28 Nëntori, Rruga 11 Nëntori, Pallati pranë Tatim Taksave, Kati 2, Elbasan.
2. Për informimin, bllokimin dhe veprimet që duhet të kryeni pas marrjes së njoftimit të këtij urdhri në lidhje me debitorët e sipërpërmendur të njoftohem në rrugë zyrtare brenda afatit administrativ nga ana Juaj.
3. Personat që bëhen pengesë, apo të cilët i paraprijnë ndonjë ndryshimi të mundshëm të pronësisë së mjeteve të luajtshme në emër të debitorëve të përmendur në pikën 1, brenda afatit të përgjigjes zyrtare, që nga dita e njoftimit të këtij urdhri, do të përgjigjen sipas dispozitave sanksionuese që parashikon Kodi i Procedurës Civile dhe Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, në lidhje me pengimin e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore apo të titujve ekzekutive.
4. Ky urdhër mbahet në 4 (katër) kopje, dhe u njoftohet palëve.

Përmbaruesi GJYQËSOR
Suela NDRËCA

